

AKTI I THEMELIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“THE ROCK TRADING”

KAPITULLI I

EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Neni 1

Themelimi

Sot, më datë 05/01/2021 në Tiranë, Shqipëri.

1.1 Emri i subjektit është: “THE ROCK TRADING” këtu më poshtë e quajtur “Shoqëria”.

1.2 Emri tregter i shoqërisë është: “TRT”

1.3 Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.4 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

1.5 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : TIRANE, Rruga Ali Demi, Pallati Nr. 72, Shkalla 5, Kati 2, Apartamenti 43, Zona Kadastrale 8150
- Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

3.1 Objekti i shoqërisë do të jetë:

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

a) Ushtrimi i aktiviteteve të pjesëmarrjes në Shoqëri, Ente, konsorciumeve dhe shoqata, si në Shqipëri dhe jashtë vendit, të financimit dhe të koordinimit teknik dhe financiar të ketyre ne menyrën e përcaktuar me ligj;

b) Promovimin dhe zhvillimin e aktiviteteve imobiliare, duke përfshirë ndërtimin, blerjen dhe shitjen, shkëmbimin, dhenien dhe marrjen me qira edhe financiare, menaxhimine pasurive të paluajtshme, ndertime dhe impiante

c) Aktivitetin e ofrimit të shërbimeve në favor të shoqerive:

- Shërbime konsulente të biznesit, drejtimi strategjik dhe organizativ, zbatimi i ristrukturimit të ndërmarrjeve, ndihmë për financim dhe pjesëmarrje në tendera.

- asistencë dhe menaxhimi të operacioneve që lidhen me blerjen dhe vlerësimin e shoqerive, dege të shoqerive, pjesëmarrje në shoqëri aksionare, komplekset e pasurive të paluajtshme, menaxhimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi, hulumtimi i bizneseve dhe ndërmjetësimi tregtar në përgjithësi;

d) Te gjithë format e kredidhenies, duke përfshirë kredine konsumatore e hipotekare:

Faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare;

Qira financiare;

Sherbimet e pagesave e të transferimit të parave;

Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;

Veprimtari të kembimit valutor, exchange, duke përfshirë edhe ato të crypto valutes;

Tregetine për llogari të vet ose të klienteve të lëtrave me vlerë të transferueshme;

Sherbime këshilluese, ndërmjetëse e sherbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër.

e) Marrë pjesë, në mënyrë direkte ose indirekte, në të gjitha transaksionet tregtare ose industriale që lidhen direkt dhe/ose indirekt me veprimtaritë e lartpërmendura, në bashkëpunim me sipërmarrje të tjera, shoqëri ose ente kombëtare, komunitare ose internacionale me objektiva të ngjashëm ose të lidhur me të vetin.

Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë, gjithashtu në rrugë ndihmëse dhe jo përcësore, të gjitha operacionet mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme tregtare dhe financiare, në Shqipëri dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ, operacione që lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë, ose me një objekt të ngjashëm, shtojcë të lidhura ose ndihmëse të të njëjtes natyre që do të favorizojë zhvillimin e saj.

Për të gjithë veprimtaritë për të cilat do të kërkojë autorizim, shoqëria do të pajiset paraprakisht me to ose të kryejë regjistrimet e nevojshme. Për zbatimin e të gjitha veprimtarive të përmendura shoqëria do të punësojë profesioniste. Shoqëria mund të aplikojë për të gjitha lehtësitat dhe përfitimet të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe nga ai që do të miratohet.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit.

Neni 4

Kohëzgjatja

4,1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR; KONTRIBUTET, KUOTAT –PJESET E KAPITALIT

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortaket

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njqindmij) Lek. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaku i mëposhtëm:

Z. **Etmond Duka**, shtetas shqiptar, lindur më 06/07/1981 në Tirane, banues në Tirane me adresë: Andrea Kushi; Nd. 3; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023, mbajtes I leternjoftimit me nr. Personal I10706204J, zotërues i një kuote të shoqërisë, me vlerë 100.000 (njqindmij) Lek, duke përfaqësuar 100% të kapitalit themeltar me të drejtë vote.

5.2 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyhet plotësisht me kontribute në para nga ortaku.

5.3 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Transferimi i Pjesëve – Kuotave

Çdo ortak mund t'ia transferojë pjesët e tij në kapitalin e Shoqërisë çdo pale të tretë, me kusht që Ortaku transferues t'u ketë njoftuar më parë me shkrim Ortakëve të tjerë të paktën 1 muaj para ("Periudha e Njoftimit") numrin e pjesëve për t'u shitur, çmimin e shitjes, identifikimin e palës së tretë dhe çdo kusht tjetër lidhur me transferimin e pjesëve. Ortakët e tjerë duhet t'i përgjigjen njoftimit të Ortakut transferues nëse dëshirojnë të blejnë pjesët sipas kushteve të vendosura në njoftim brenda periudhës së njoftimit. Në rast të një përgjigjeje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Ortaku transferues mund të procedojë me transferimin e pjesëve te pala e tretë.

KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 7

Asambleja e Përgjithshme

7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakort me këto vendime.

7.2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:

- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratori;
- Emeron dhe shkarkon administratoret
- Përcakton shpërblimin e administratoreve;
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori;
- Merr vendimin për ndryshimet e këtij statute dhe të aktit të themelimit;
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- Merr vendimin për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- Merr vendimin për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për çdo ceshtje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 8

Thirrja

8.1 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mund te thirret nga Adminisratori(ret) apo secili prej Ortakeve sipas legjislacionit ne fuqi.


8.2 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme zhvillohet normalisht ne seline e Shoqerise ose ne nje vend tjetër Brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

8.3 Asambleja e Pergjithshme shprehet ne menyre te vecante per cdo ceshtje te rendit te dites , per te cilen duhet te merret nje vendim I vecante.

8.4 Ortaket mund te marrin pjese ne Asamblene e Pergjithshme personalisht ose nepermjet perfaqesuesit te autorizuar me procure. Administratori (et) e shoqerise nuk mund te perfaqesojne Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme.

Neni 9

Procesi i vendimmarrjes



9.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme, por në cdo rast të paktën njeherë në vit.

9.2 Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortaket që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

9.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë, në lidhje me çështje për të cilat ligji nuk kërkon një shumicë të cilësuar përcaktuar në pikën 9.4 si më poshtë.

9.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej $\frac{3}{4}$ e votive të ortakeve të pranishëm në lidhje me:

- i. Ndryshimin e Statutit;
- ii. Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit;
- iii. Shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- iv. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Neni 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2 Administratori i shoqërisë është :

- **Z. Etmond Duka**, shtetas shqiptar, lindur më 06/07/1981 në Tirane, banues në Tirane, mbajtes I leternjoftimit me nr. Personal I10706204J

10.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5(pesë) vjetesh, i rinovueshëm dhe nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

10.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori. Administratori ka të drejtë të leshojë prokura apo autorizime të veçanta, përveçse kur parashikohet ndryshe.

10.5 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me cdo palë të tretë;
- Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrë të duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;



- Pergatitjen dhe nenshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve te konsoliduara, pergatitjen e raportit te ecurise dhe dorezimin e ketyre te fundit bashke me propozimin perkates per shperndarjen e fitimeve Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- Krijimin e sistemit te paralajmerimit ne lidhje me rrethanat, te cilat kercenojne veprimtarine e shoqerise;
- Dorezimin ne Qendren Kombetare te Biznesit te dokumentave dhe te te dhenave te shoqerise, pervec rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
- Raportimin ne Asamblene e pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise dhe ne lidhje me epermbushjen e transaksioneve ten je rendesie te vecante per ecurine e Shoqerise;
- Kryerjen e cdo detyre tjeter te parashikuar nga ligji ose nga ky statut;

10.6 Administratori mund te autorizoj nepermjet nje procure nje pale te trete te perfaqesoje Shoqerine dhe te nenshkruaje cdo document, kerkese ose aplikim ne emer dhe per llogari te shoqerise.

10.7 Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise per cdo dem te shkaktuar si pasoje e mospermbushjes se detyrimeve te parashikuara nga dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacioni ne fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR- SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 11

Viti financiar

11.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

11.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2021.

Neni 12

Shpërndarja e fitimeve

12.1 Pas miratimit të pasqyrave financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimeve.



12.2 Në rast se pas miratimit të pasqyrave financiare Shoqëria rezulton me humbje, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me mbulimin e humbjeve.

KAPITULLI V

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

13.1 Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e shoqërisë, do të emërohen një ose më shumë likuidues.

KAPITULLI VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Ligji I Zbatueshëm

14.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqërinte tregtare.

Neni 15

Të ndryshme

15.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje te njehta, origjinale në gjuhën shqipe.

Ortaku

Etmond Duka

